



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 85 Akti

Nr. 107 Vendimi

Tiranë, më 14.02.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari
Suela Zhegu
Brunilda Bekteshi

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 13 shkurt 2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artan Sabri Bajrami, me funksion prokuror,** Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, i cili pranoi rezultatet e hetimit dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,** miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, me funksion prokuror, Drejtues pranë Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. John Leonardo.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

➤ *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018.

- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami”.

Prokuroria e Përgjithshme, (në vijim PP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 31.01.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Bajrami, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, z. Artan Bajrami, i janë garantuar të drejtat, si: për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ në datën 31 janar 2019 duke i kaluar barrën e provës. Për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, ju dha 8 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Z. Artan Bajrami, u njoh me rezultatet e hetimit dhe ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij më datë 08.02.2019. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin KDZH nr. *** , datë 11.04.2018.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 28.04.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 08.02.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.02.2019, ora 09:30, në adresën: Pallati i Koncerteve, salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar

me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- (c) Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar-Vetting dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit pranë ILDKPKI;
- (ç) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja;
- (dh) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga Prokuroria e Përgjithshme;
- (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- (f) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, me funksion prokuror, Drejtues pranë Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

i. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, është bërë subjekt deklarues në vitin 2003, me numër indeksi 02020 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private nga viti 2003 - 2016 si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (deklarata “Vetting”).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklaratim të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaron këto pasuri:

1. **Apartament**⁴, me sipërfaqe 111 m² (2+1), i ndodhur në qytetin e Tiranës, i blerë në vitin 2000, me vlerë 45,000 USD.
2. **Apartament**⁵, me sipërfaqe 55 m² dhe verandë me sipërfaqe 110 m², i ndodhur në ***, Durrës, i prenotuar në vitin 2006, me vlerë 30,000 euro.
3. **Pasuri e paluajtshme, pyll dhe kullotë**⁶, përfituar sipas VKKP-së nr. 100, datë 06.07.2006, qarku Elbasan. Pjesa në %, deklaruar ½ e 1/11 pjesë.
4. **Gjendje e llogarisë së pagës**⁷, më datë 24.01.2017, në vlerën prej 21,422.11 lekësh.

Pasuri të deklaruara veçmas nga personat e lidhur (bashkëshortja, vajza dhe djali i subjektit të rivlerësimit):

5. **Apartament (2+1)**, me sipërfaqe 92 m² dhe një **vend parkimi**⁸, në Tiranë, me vlerë totale prej 9,800,000 lekësh, të prenotuara nga vajza e subjektit të rivlerësimit në vitin 2014.
6. Gjendja e llogarisë së pagës së bashkëshortes⁹ (datë 24.01.2017), me vlerë – 1,752 lekë.
7. Gjendje e llogarisë së pagës së vajzës¹⁰ (datë 24.01.2017), vlera prej 166,529 lekësh.
8. **Autoveturë, tip “Audi A3”**¹¹, me vlerë 5,000 euro, i blerë nga djali i subjektit, në vitin 2014.
9. Gjendja e llogarisë së pagës¹² së djalit të subjektit (datë 24.01.2017), vlera prej 535 lekësh.

HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI LIDHUR ME KËTO PASURI

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 111 m², i blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2000, i ndodhur në bulevardin “****”, pallati i shoqërisë “****” sh.p.k., Tiranë, me vlerë 45,000 dollarë.

Në deklaratën “Vetting” si burim të krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar:

⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë shitje me kusht nr. *** rep., nr. *** kol.;
- kontratë huaje për blerje banese me nr. *** rep., nr. *** kol, datë 05.05.2000;
- kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.05.2000;
- vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.05.1993.

⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë porosie, datë 18.05.2006.

⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së):

- vendimin e VKKP-së Qarku Elbasan, me nr. ***, datë 06.07.2006.

⁷ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së):

- konfirmim për gjendjen e llogarisë nga “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 24.01.2017.

⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë sipërmarrje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.01.2014;
- kontratë huaje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.02.2014;
- kontratë depozite me afat e lidhur më datë 05.10.2012 me “Credins Bank”;
- faturë tërheqje nga llogaria në “Credins Bank”, datë 08.10.2014.

⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/19 në dosjen e ILDKPKI-së):

- nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 23.01.2017

¹⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së):

- statement bankar nga “Tirana Bank”, i datës 24.01.2017.

¹¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së):

- kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.10.2014;
- certifikatë pronësie mjeti.

¹² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së):

- vërtetim nga Credins Bank me nr. *** prot., datë 24.01.2017.

- i. marrjen e huas prej 5,000,000 lekësh, me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.05.2000, të lidhur me Bankën Kursimeve;
- ii. të ardhurat nga shitja e banesës në Gramsh (të përfituar nga privatizimi), në vlerën prej 4,000 USD, sipas kontratës së shitjes së datës 19.11.1996;
- iii. kursimet ndër vite nga pagat.

Mënyra e fitimit të pasurisë: Kontrata e shitjes me kusht, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.04.2000, lidhur mes shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe z. Artan Bajrami në cilësinë e palës blerëse.

Referuar “**Deklaratës Fillestare të vitit 2003**” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar apartament banimi, me sipërfaqe 111 m², ndodhur në Tiranë:

- vlera e deklaruar: 6,500,000 (gjashtë milion e pesëqindmijë) lekë;
- pjesa që zotëron në përqindje: 50 % ;
- me adresë: Bulevardi “***”, Rr. “***”, pallati “***”;
- Si burim të krijimit subjekti ka deklaruar:
 - i. kredia në Bankën e Kursimeve, në vlerën prej 5,000,000 lekësh dhe
 - ii. shuma 1,500,000 lekë nga të ardhurat në vite.

Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në:

- vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe
- burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Komisioni ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga institucionet, si më poshtë:

ZVRPP Tiranë, iu kërkuar informacion lidhur me këtë pasuri, veprimet e kryera për kalimin e pronësisë në emër të shtetasit Artan Bajrami dhe informacion lidhur me bllokimin e kësaj pasurie, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

ZVRPP Tiranë¹³ me përgjigjet e dërguara, ka konfirmuar se kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit Artan Bajrami nëpërmjet kontratës së shitjes¹⁴ me nr. *** rep., nr. *** kol., që i përket referencës me nr. *** hipotekor, datë 26.04.2000.

“**Raiffeisen Bank**”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.02.2018, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit është kredimarrës pranë kësaj banke, për një kredi të marrë, më datë 05.05.2000, në shumën prej 5,000,000 lekësh dhe se aktualisht detyrimi i pashlyer i kredisë është në shumën 1,871,167.34 lekë. Bashkëlidhur shkresës, ka dërguar dhe kontratën e huas, kontratën e hipotekimit dhe dokumentacion shoqëruar lidhur me këtë kredi.

¹³Përgjigjet e dërguara nga ZVRPP Tiranë me, shkresat me nr. *** prot., datë 04.12.2018; nr. ***prot., datë 12.12.2018; nr. ***prot., datë 21.01.2019.

¹⁴ kontratë e shitjes me kusht lidhur midis shoqërisë “***” dhe z. Artan Bajrami

“**Raiffeisen Bank**”, me shkresën nr. ***prot., datë 23.10.2018, na dërgon “dosjen e plotë të kredisë”, e cila përmban:

- “*Kontratën e Huas*”, datë 05.05.2000, në emër të, z. Artan S. Bajrami.

Nga verifikimi i “dosjes së kredisë”, konfirmohet se, më datë 05.05.2000, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e huas për blerje banese me nr. *** rep., nr. *** kol., me palë huadhënëse Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), shuma e akorduar në vlerën prej 5,000,000 lekësh.

- “**Kontrata e Hipotekimit**” me nr. *** rep., nr. *** kol., ku konstatohet se, më datë 05.05.2000, është lidhur me palë hipotekuese: z. Artan Bajrami me bashkëshorten e tij dhe palë përfituese: Banka e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), me objekt: “*Hipotekimi i pasurisë së paluajtshme të hipotekuesit për efekt të sigurimit të kredisë së lëvruar nga Përfituesi, në shumën 5,000,000 lekë.*”

Referuar kësaj kontrate konstatohet se, hipotekuesit¹⁵ në bazë të regjistrit hipotekor nr. ***, datë 26.04.2000, në zonën kadastrale nr. ***, kanë në pronësi të tyre një apartament banimi i ndodhur në rrugën/bulevardin “***”, godina nr. *** jeshile, apartamenti nr. ***, që ndodhet në katin e pestë, Tiranë, me sipërfaqe 111 m² dhe përbëhet nga 2 dhoma, një dhomë ndenje me kuzhinë dhe dy banja, si dhe ambiente ndihmëse.

- “**Kontrata e shitblerjes**” me nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 18.04.2000.

- **Vërtetim i lëshuar nga ZVRPP Tirana** ***, më datë 05.05.2000, sipas të cilit konfirmohet se kontrata e hipotekimit me nr. *** rep., nr. *** kol., është regjistruar në regjistrin e inskriptimeve me nr. ***, datë 05.05.2000.

Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje vëren se:

✓ **Informacioni i ardhur nga ZVRPP Tiranë, përputhet me dokumentacionin që përmban “dosja e plotë e kredisë”.**

Sipas procesverbalit¹⁶ të mbajtur pranë ILDKPKI-së, nga shpjegimet e subjektit më datë 23.02.2016 dhe nga përgjigjet e pyetësorëve të dërguara nga subjekti pranë këtij Komisioni, subjekti ka deklaruar se: “*Ky apartament fillimisht është prenotuar nga shtetasi P. A¹⁷ sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., e vitit 1998 dhe se, më datë 18.04.2000, subjekti i rivlerësimit duke kaluar në cilësinë e blerësit ka lidhur kontratën e shitjes me kusht me shoqërinë “Teknoprojekt” sh.p.k.*

Subjekti i rivlerësimit i pyetur nga Komisioni, ndër të tjera ka deklaruar se: “*Shuma prej 4,000 USD ka shërbyer për efekte të prenotimit vetëm në momentin fillestar të apartamentit ku banon, sipas kontratës së porosisë, datë 25.04.1999, të lidhur ndërmjet z. P. A (djali të baxhanakut të tij) me shoqërinë e ndërtimit. Ka deklaruar se, për blerjen e shtëpisë së tij në Tiranë ka*

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit

¹⁶ mbajtur mes inspektorëve të ILDKPKI-së dhe subjektit të rivlerësimit

¹⁷ djali i baxhanakut të tij

*kontribut vetëm shumë të kredisë, dhe pjesa tjetër është mbuluar nga familja A.. Përfundimisht, shpjegon se shuma prej 4,000 USD është përdorur për prenotimin e apartamentit në *** sipas kontratës së porosisë datë 18.05.2006.”*

*Ky deklaram është konfirmuar dhe nga z. Ll. A, nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.11.2018, i cili deklaron se ka kontribuar financiarisht në shumën prej 1,500,000 lekësh për blerjen e banesës në Tiranë, të subjektit të rivlerësimit”.*

Komisioni nga verifikimi i deklaratës “Vetting”, krahasuar me deklaratimet para fillimit të detyrës në vitin 2003:

- ➔ **ka konstatuar pasaktësi dhe mospërputhje në deklarime lidhur me burimin e krijimit** nga subjekti i rivlerësimit, për pagesën e kështit prej 1.5 milion lekë për blerjen e apartamentit në Tiranë, sa më poshtë vijojnë:
- në **deklaratën “Vetting”** deklarohet si burim, shuma 4,000 USD nga shitja e apartamentit në Gramsh dhe kursimet ndër vite nga pagat;
 - në **“deklaratën e vitit 2003”**, deklarohet si burim shuma nga të ardhurat në vite.

Gjatë hetimit përpara Komisionit subjekti ka deklaruar se,

- shuma prej 4,000USD është përdorur për prenotimin e apartamentit në *** sipas kontratës së porosisë datë 18.05.2006 dhe
- pagesa prej 1.5 milion lekë është deklaruar nga subjekti **“si dhuratë”** nga z. Ll. A.

Lidhur me këto mospërputhje deklarimesh subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e Komisionit. Subjekti ndër të tjera, ka shpjeguar se, “*pagesa në shumën 1.5 milion lekë nuk është kryer prej tij, por nga shtetasi Ll. A si “dhuratë”. Për këtë qëllim subjekti ka depozituar edhe një **deklaratë noteriale**, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.11.2018, të shtetasit Ll. A, i cili deklaron se ka kontribuar financiarisht në shumën prej 1,500,000 lekësh për blerjen e banesës së subjektit të rivlerësimit në Tiranë dhe pjesa tjetër prej 5,000,000 lekësh u mbulua me kredi nga ana e subjektit. Kjo për shkak të lidhjeve të tyre familjare. Subjekti në shpjegimet e tij ka sqaruar shprehimisht se: “Deklarimi në deklaratën “Vetting” se shuma prej 4,000 USD është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, është **lajthitje nga ana ime, që mund të ketë ardhur nga pakujdesia gjatë plotësimit të formularit...**”*

Arsyetim ligjor

Në mbështetje të pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit, dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe sipas pikës 3 të po këtij neni, ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

Deklarimet e subjektit përpara Komisionit të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, siç është deklarata e shtetasit Ll. A përpara noterit publik, janë deklarime krejtësisht të ndryshme nga deklaratimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratën “Vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të këtij aseti. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratat periodike vjetore nuk ka deklaruar “dhurimet”, përfshirë dhe dhurimin e shumës prej 1,300,000 lekësh apo 1,500,000 lekë nga shtetasi Ll. A, për të cilën ka deklaruar se ka shërbyer si burim

për krijimin e apartamentit, të blerë nga ana e tij në vitin 2000. Si rrjedhim, nuk ka prova që të mbështesin deklaratimet e subjektit, të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

Mosdeklarimi i “**dhurimit**” si burim në shumën prej 1.5 milion lekësh në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e vitit 2003, për blerjen e banesës në Tiranë, e vë subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaratimit të rremë.

Komisioni vlerëson se,

➔ ***Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” mbi burimin e krijimit, për pagesën e kështit prej 1.5 milion lekë në blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi në deklaratën vetting subjekti ka deklaruar si burim shumën prej 4,000\$ nga shitja e apartamentit në Gramsh dhe kursimet ndër vite nga pagat, ndërsa gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore deklaroi se burim janë të ardhurat e dhuruara nga shtetasi LL.A.***

Gjatë hetimit administrativ u evidentuan dhe “dhurime” të tjera nga z. Ll. A në favor të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, të pasqyruara si më poshtë:

- i. vlera prej 1,300,000 lekësh/1,500,000 lekësh, për apartamentin e blerë në vitin 2000;
- ii. vlera prej 1,500 eurosh (konvertuar 207,450 lekë), për studimet e djalit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2011;
- iii. vlera prej 1,800 eurosh (konvertuar 251,500 lekë) për shërbime mjekësore dhe udhëtim të bashkëshortes së subjektit në vitin 2012;
- iv. vlera prej 150,000 lekësh paguar për studimet e djalit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013 dhe 2014;
- v. vlera prej 900 eurosh (konvertuar 125,000 lekë), për operacionin e djalit të subjektit të kryer në Turqi, periudha e padeklaruar.

✓ ***Totali i dhurimeve të deklaruara si të përfituara prej shtetasit Ll. A, janë në vlerën prej 2,234,400 lekësh apo rreth 16,600 euro.***

Komisioni vëren se, asnjë prej dhurimeve/sponsorizimeve të referuara në deklaratën noteriale të z. Ll. A (datë 29.11.18), si edhe ato të vetdeklaruara nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit të datës 04.12.2018, nuk janë deklaruar nga ana e subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”.

Bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se shtetasi Ll. A bën pjesë në kategorinë e “personave të tjerë të lidhur”, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Komisioni ka kryer verifikime, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Ll. A. Nga verifikimi i kryer në faqen e Web-it të QKB-së, nga kërkimi i bërë në fushën “aksioneri” me emrin Ll. A ka rezultuar, si aksioner/administrator në 15 biznese (shoqëri tregtare apo persona fizikë) të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni ka kërkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, evidentimin e aftësisë paguese të z. Ll. A, të dhëna lidhur me të ardhurat e realizuara, fitimet e deklaruar, fitimin neto mbas tatimit, dividendin e shpërndarë dhe pagesën e tatimit mbi dividendin, për shoqëritë “****” sh.a., “****” sh.a., “****” sh.a., “****”, meqenëse këto shoqëri janë përmendur në deklaratën noteriale të dorëzuar prej tij pranë Komisionit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁸ ka konfirmuar se këto shoqëri kanë realizuar fitime të konsiderueshme përgjatë periudhës që kanë ushtruar aktivitetet.

✓ ***Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatoi se shtetasi Ll. A, si personi tjetër i lidhur disponon burime financiare të ligjshme për të kryer dhurimet në favor të subjektit të rivlerësimit.***

Komisioni në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, i ka kërkuar shoqërisë “****” sh.p.k., kopje të dy kontratave të lidhura me shtetasit P. A dhe Artan Bajrami si edhe të na konfirmojë mënyrën e kryerjes së pagesës lidhur me këto dy kontrata, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Shoqëria “**” sh.p.k.**,¹⁹ na informon se:

Z. P. A (djali i Ll.) ka lidhur kontratë sipërmarrje me këtë shoqëri, me nr. *** kol., nr. *** rep., datë 25.04.1998, dhe se ka likuiduar shumën totale prej 45,000 USD, për prenotimin e apartamentit nr. 14, me sipërfaqe 111 m², në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në bulevardin “****”, Tiranë. Më pas, z. P. A, ka kërkuar që kontrata e shitjes për këtë apartament të bëhej në emër të z. Artan Bajrami, i cili do ti kthente z. P. A vetëm shumën 5,000,000 lekë, të cilat do ti merrte kredi nga Banka e Kursimeve, kjo për shkak të lidhjeve të tyre familjare. Me kërkesën e tyre shoqëria përpiloi kontratën e shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.04.2000,²⁰ me palë blerëse z. Artan Bajrami.

Në vijim shoqëria “****” sh.p.k., na informon se, z. Artan Bajrami, mori kredinë nga Banka e Kursimeve në shumën prej 5,000,000 lekësh, shumë e cila u xhirua në llogarinë e saj bankare, shoqëria ia ktheu këtë shumë z. P. A. Por, nuk është dorëzuar dokumentacioni justifikues ligjor, për të konfirmuar faktin se shoqëria ja ka kthyer këtë shumë z. P. A.

Në kontratën e shitjes me kusht të lidhur mes subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit, më datë 18.04.2000, parashikohet se: *“Shoqëria ia shet apartamentin, z. Artan Bajrami, me një shumë prej 45,000 USD ose 6.3 milion lekësh²¹, nga të cilat ka paguar në arkën e shoqërisë 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë, kurse pjesa tjetër do paguhet nga blerësi në momentin që ai do marrë kredi në Bankën e Kursimeve”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit që shoqëron dosjen e kredisë konstatohet, urdhër xhirimi i jashtëm me nr. 0850266, i bërë pranë Bankës së Kursimeve, sipas të cilit z. Artan Bajrami ka kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., shumën prej 5,000,000 lekësh me përshkrimin:

¹⁸ DTM-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.01.2019; DRT-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2019.

¹⁹ Shkresë “kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 03.01.2019.

²⁰ Ka bashkëlidhur shkresës një deklaratë të z. P. A që mban datën 14.04.2000.

²¹ Mendohet të jetë lapsus dhe të jetë shënuar gabimisht në kontratë, në vend të shumës prej gjashtë milion e treqind mijë lekë.

*“Likuidojmë me kredi sipas kontratës së shitjes, datë 18.04.2000, me nr. ***, noterizuar dhe VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999.”*

Komisioni sa më sipër ka konstatuar se:

- ✓ *Subjekti me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ ka cenuar dhe “Kontratën e shitjes me kusht” të vitit 2000, pasi në të thuhet se ai ka paguar në arkën e shoqërisë shumë prej 1,300,000 lekësh.*
- ✓ *z. Artan Bajrami, ka paguar për këtë apartament vetëm shumë prej 5 milion lekë, ku provohet se kredia e akorduar nga Banka e Kursimeve, ka kaluar nëpërmjet urdhër xhirim të jashtëm në shumë prej 5 milion lekësh në favor të shoqërisë “Teknoprojekt” sh.p.k.*

2. Apartament, me sipërfaqe 55 m² dhe verandë 110 m², i ndodhur në *, Kavajë, i prenotuar në vitin 2006, me vlerë 30,000 euro, nga të cilat janë paguar vetëm 20,000 euro.** Si burim të krijimit të saj, subjekti ka deklaruar kursime në vite nga pagat. Kjo pasuri është fituar nëpërmjet kontratës së porosisë, datë 18.05.2006, lidhur midis z. Artan Bajrami dhe shoqërisë “***”*** sh.p.k.

Referuar Deklaratës Periodike Vjetore (në vijim DPV) të vitit 2006, subjekti ka deklaruar prenotim apartamenti me firmën “*** dje ***”, sipas kontratës së porosisë të datës 18.05.2006:

- i. vlera e deklaruar e apartamentit: 30,000 (tridhjetëmijë) euro;
- ii. sipërfaqja: 55 m² + 110 m² verandë;
- iii. vendndodhja: ***, Plazh;
- iv. pagesa e kryer: deklaruar se është paguar shuma prej 20,000 eurosh sipas mandatarkëtimit nr. 15, datë 17.05.2006;
- v. burimi i krijimit (i kryerje së pagesës): pakësuar kursimet e deklaruar më parë.

Komisioni ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga institucionet, si më poshtë:

ZVRPP Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.02.2018, nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.

Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, me shkresën nr. *** prot., datë 16.02.2018, na informon se z. Artan S. Bajrami rezulton aplikues në procesin e legalizimeve.

Drejtoria e ALUIZNI-t, Zona Turistike, me shkresën nr. *** prot., datë 30.08.2018, na dërgon kopje të dokumentacionit që disponon në emër të z. Artan Sabri Bajrami.

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur kësaj shkrese konstatohet se, nëpërmjet Formularit 2, “Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar”, të dorëzuar në zyrat e ALUIZNI-t, më datë 04.10.2010, subjekti ka deklaruar të dhënat e njësisë së ndërtuar, si më poshtë:

- i. emri i zonës së simuluar dhe vendndodhja: ***;
- ii. sipërfaqja e bazës së ndërtuar: 160 m²;
- iii. sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar: 160 m²;
- iv. numri i kateve 3 dhe funksioni i njësisë së ndërtuar: Banim;
- v. sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë: 330 m².

Gjithashtu referuar këtij formulari, është shënuar se subjekti bashkë me kërkesën, ndër të tjera ka dorëzuar (1) marrëveshjen e qerasë dhe/ose zhvillimit dhe (2) lejen e ndërtimit të njësisë së ndërtuar, *por këto dokumente nuk gjenden në dosjen e dërguar pranë Komisionit.*

Drejtoria e ALUIZNI-t Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.02.2018, na konfirmon se, pranë kësaj drejtorie rezulton si vetëdeklarues, z. Artan S. Bajrami, i datëlindjes 14.06.1958 dhe se dosja e tij ende nuk është punuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur kësaj shkrese konstatohet se, nëpërmjet “*Deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim pa leje*”²², subjekti ka vetëdeklaruar:

- i. Shtesë anësore në ndërtim me leje;
- ii. Ndërtimi është i ngritur më: *vitin 2008*;
- iii. Adresa e ndërtimit: *në fshatin ***, Plazh, në Kavajë.*

Gjithashtu konstatohet se, pranë kësaj drejtorie subjekti, më datë 04.10.2010, nëpërmjet Formularit, “*Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar*”, ka deklaruar të dhënat e njësisë së ndërtuar, si më poshtë:

- i. Sipërfaqja e bazës së ndërtuar: 80 m²;
- ii. Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar: 80 m²;
- iii. Numri i kateve dhe funksioni i njësisë së ndërtuar: Banim;
- iv. Sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë: 330 m².

Njësia Administrative ***, pranë **Bashkisë Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 05.11.2008, na dërgon dosjen e plotë mbi bazën e të cilës ka dhënë lejen e ndërtimit me nr. ***, datë 10.07.2004, në favor të investitorëve “***” sh.p.k., dhe “***” sh.p.k., për ndërtimin e kompleksit ku përfshihet dhe kjo pasuri e subjektit të rivlerësimit.

Analiza e kryer nga Komisioni, për këtë pasuri.

Referuar kontratës së porosisë së datës 18.05.2006, subjekti i rivlerësimit ka porositur nga sipërmarrësi firma “***” sh.p.k., një apartament në kompleksin ***, ***, Kavajë, parcela nr. ***, e pajisur me leje ndërtimi nr. ***, datë 10.07.2004, nga KRRT-ja e Komunës ***.

Në kontratë parashikohet se: “*Për çdo vonesë në përfundimin e apartamentit, përtej sa i është përcaktuar në kontratën bazë me “***” sh.p.k., person i simuluar (gjithsej 24 muaj), shitësi i*

²² Konstatohet se kjo deklaratë është protokolluar në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë me nr. *** prot., datë 30.01.2015.

paguan porositesit një penalitet prej 20 euro në muaj". Këtu evidentohet disi roli i shoqërisë "****" (***).

Komisioni, nga kërkimi i bërë në faqen e Web-it të QKB-së ka evidentuar se, shoqëria "****" (më parë ka pasur emrin tregtar ***) e cila mban NIPT ***, dhe aktualisht ka si administrator, z. F. I, i cili është administrator edhe në shoqërinë "****" sh.p.k., me NIPT ***.

Gjithashtu, në këtë kontratë vërehen korrigjime me shkrim të lirë dore që kanë të bëjnë me çmimin e këtij apartamenti dhe vlerës së kësteve që duhet të paguante subjekti i rivlerësimit. Sipas kësaj kontrate çmimi për çdo apartament është 28,000 euro (korrigjuar me shkrim të lirë dore në vlerën prej 30,000 eurosh), i ndarë sipas këtyre kësteve:

- i. Kësti i parë me nënshkrimin e kontratës. Gjithsej 40 % e shumës, vlera 11,000 euro (korrigjuar me shkrim të lirë dore vlera prej 20,000 eurosh);
 - ii. Kësti i dytë 90 ditë pas pagimit të kështit të parë. Vlera në këtë këst 40 % e shumës, vlera 11,000 euro;
 - iii. Kësti i tretë 90 ditë pas pagimit të kështit të dytë. Vlera do të jetë 15% e shumës, vlera 4,500 euro.
 - iv. Me përfundimin e apartamentit blerësi paguan edhe 5 % të shumës, në vlerën prej 1,500 eurosh.
- Parashikohet se, me bërjen e hipotekimit porositesit dhe shitësi nënshkruajnë para noterit kontratën e shitblerjes.

Sikurse e kemi pasqyruar edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e këtij apartamenti është 30,000 euro, nga të cilat i ka paguar shoqërisë vetëm vlerën 20,000 euro.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegoj, **arsyen e mospagimit të detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë "****"*** apo "****"** dhe se kur mendon të paguaj shumën e mbetur prej 10,000 eurosh. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *"Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë "****"*** apo "****", në shumën prej 10,000 eurosh nuk është paguar, për arsye se nuk është bërë i mundur hipotekimi i ndërtimit, pjesë e së cilës është banesa e prenotuar me kontratën e porosisë datë 18.05.2006. Në vijim ai sqaron se, me marrëveshje të pashkruar kanë rënë dakord që detyrimi i mbetur të shlyhej me marrjen në dorë të certifikatës së pronësisë, gjë e cila nuk ka ndodhur edhe sot. Në këto kushte, thotë se shlyerjen e këtij detyrimi do ta përmbush në momentin e regjistrimit të këtij ndërtimi (pasurisë) pranë ZVRPP-së nga shitësi si edhe pajisjen e tij me certifikatë pronësie."*

Edhe në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së²³, subjekti ka mbajtur të njëjtit qëndrim duke konfirmuar se i detyrohet shoqërisë "****" shumën prej 10,000 eurosh dhe se sipas një marrëveshje verbale me firmën, kjo shumë do të shlyhet kur pasuria të hipotekohet.

➔ **Nga analiza e të dhënave të mësipërme vërejmë se, nuk përlligjen shpjegimet e subjektit lidhur me mospagimin e shumës prej 10,000 eurosh në favor të shoqërisë, kjo pasi:**

²³ Me procesverbalin e datës 23.02.2016, "Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive".

Së pari, në kontratë është parashikuar qartë mënyra e likuidimit të çmimit, si rrjedhojë subjekti duhej t'i përmbahej kontratës për kryerjen e pagesave dhe se nuk provohen pretendimet e tij për marrëveshjen e pashkruar mes tij dhe shoqërisë për shtyrjen e pagesave, deri në momentin e hipotekimit të objektit, pasi në kontratë nuk është vendosur si kusht hipotekimi i pasurisë për kryerjen e plotë të pagesave por vetëm dorëzimi i objektit.

Së dyti, nga verifikimi i dosjes së ardhur nga Njësia Administrative ***, rezulton se KRRT-ja e ish-Komunës ***, ka pajisur me leje ndërtimi shoqëritë “***” dhe “***” në vijim të Vendimit nr. 15, datë 02.03.2004, të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, me anë të së cilit mbështetur në ligjin nr. 7665, datë 21.01.1993, “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” kanë miratuar veprimtarinë e simuluar dhe i kanë dhënë titullin, “person i simuluar”, subjekteve “***”. Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, ky fakt është pasqyruar edhe në kontratën e porosisë së lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “***”. Pra, subjekti ka pasur dijeni se në ndërtimin e këtij kompleksi rezidencial po zhvillohej veprimtari e simuluar nga personi i simuluar subjekti “***”. Në këtë kuptim, subjekti duhet të kishte dijeni se pasuritë pjesë përbërëse të këtij kompleksi rezidencial, në atë periudhë nuk mund të shiteshin por vetëm mund të jepeshin me qira për zhvillimin e aktivitetit turistik, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 7665, datë 21.01.1993, “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”. Pikërisht, edhe në kontratën e porosisë parashikohet se: *“Porositësi duhet të paguaj dhe një qira vjetore ndaj shtetit për truallin mbi të cilin është ndërtuar rezidenca turistike, e cila sipas tarifave është 0,9USD për m², në vit”*.

Nga evidentimi faktik dhe kontrolli i dokumentacionit ligjor për zonën e simuluar, rezulton se subjekti Artan Bajrami posedon një apartament (sipas kontratës së porosisë së datës 18.05.2006) në një godinë që gëzohet në bashkëpronësi me subjekte të tjerë.

Drejtoria e ALUIZNI-t Zona Turistike²⁴, në lidhje me aplikimin e subjektit me nr. *** prot., datë 30.01.2015, për shtesë anësore në objekt me leje na informon se pas evidentimit në terren ka rezultuar se:

- ✓ ***Subjekti ka deklaruar një sipërfaqe verandë të mbuluar me konstrukcion të lehtësuar që nuk përbën objekt për legalizim, në kuptim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, si edhe Vendimit nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave e Dokumentacionit të Zbatueshëm për të Kualifikuar Ndërtimet pa Leje, Shtesat Anësore dhe/ose në Lartësi, në Ndërtime me Leje”, i ndryshuar.***

Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie:

Referuar deklaratës fillestare të dorëzuar pranë ILDKPKI-së (viti 2003), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet, gjendjen *cash*, shumën prej 15,000 USD, nga të cilat 10,000 USD ka deklaruar se i disponon në banesë dhe 5,000 USD ia ka dhënë borxh vëllait.

²⁴ me shkresën nr. *** pro., datë 27.11.2018.

Si burim të krijimit të shumës prej 15,000 USD, ka deklaruar (1) shumën 4,000 USD nga shitja e banesës në Gramsh në vitin 1996 dhe (2) shumën 11,000 USD kursime për periudhën 10 vjeçare.

Subjekti u pyet nga Komisioni nëse shuma prej 5,000 USD i është kthyer nga vëllai i tij dhe nëse **Po**, të na deklarojë periudhën se kur i është kthyer. Subjekti i rivlerësimit na deklaroi se: *“Shuma prej 5,000 dollarësh dhënë hua vëllait të tij i është kthyer në muajin prill të vitit 2004”*.

Referuar DPV 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre) - Gjendje *cash*, në shumën prej 400,000 lekësh.

Referuar DPV 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre) - Kursime *cash*, në shumën prej 250,000 lekësh.

Referuar DPV 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesat/pakësimet e gjendjeve *cash*: (1) pakësuar gjendja e *cash-it* me vlerën prej 20,000 eurosh, shumë e cila ka të bëjë me pagesën për prenotimin e apartamentit në ***, Kavajë dhe (2) kursime *cash*, në vlerën prej 200,000 lekësh.

➔ **Komisioni ka evidentuar pasaktësi në deklarim për shumën prej 4,000 USD, e përfituar nga shitja e apartamentit të tij në Gramsh, pasi në “deklaratën fillestare të vitit 2003” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.03.2004, është deklaruar se ka shërbyer në krijimin e gjendjes së *cash-it* në shumën prej 15,000 USD, ndërsa në deklaratën “Vetting” është deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në vitin 2000. Për më tepër, subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm të ardhurat nga paga e tij.**

Analiza financiare për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në vlerën 15,000 USD deklaruar në DVP 2003.

Meqenëse në vitin 2003, është bërë deklarimi për herë të parë nga ana e subjektit, dhe bazuar në këtë deklarim mbi gjendjen e *cash* të krijuar si kursime nga pagat dhe shumës 4,000 USD nga shitja e apartamentit në Gramsh në vitin 1996, është analizuar periudha pas blerjes së apartamentit, domethënë pas datës 05.05.2000 deri në Dhjetor 2003.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton e provuar se subjekti ka shitur në vitin 1996 apartamentin në Gramsh në shumën prej 4,000 USD. Nisur nga vetëdeklarimet e subjektit dhe qëndrimi i mbajtur prej tij përpara Komisionit, në analizën financiare shuma prej 4,000 USD është përfshirë në kursimet e përmendura në DPV 2003, që do të thotë se subjekti ka krijuar gjendjen *cash* ndër vite, shumën prej 11,000 USD nga kursimet nga pagat dhe shumën 4,000 USD e ka mbartur që prej vitit 1996 nga shitja e apartamentit në Gramsh.

Të dhënat lidhur me të ardhurat, shpenzimet, pasuritë, detyrimet për periudhën maj 2000 deri në dhjetor 2003 reflektohen në tabelën sa më poshtë;

Nr.	Përshkrimi	Maj - Dhjetor 2000	2001	2002	2003	Total
-----	------------	-----------------------	------	------	------	-------

1	TË ARDHURA	460 532	1 117 656	2 031 597	2 253 447	5 863 232
	<i>Nga shitja e apartamentit në 1996</i>				433 278	
2	SHPENZIME	407 540	513 324	310 504	710 541	1 941 908
3	PASURI				1 085 418	1 085 418
4	DETYRIME	37 014	67 684	70 504	616 774	791 976
		15 978	536 649	1 650 590	- 159 286	2 043 931

- ✓ *Nga analiza financiare sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash prej 11,000 USD gjatë periudhës për vitet 2000 - 2003.*

Komisioni, analizoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për pagesën e kryer në shumën prej 20,000 eurosh për pronotimin e apartamentit në *** në vitin 2006, e pasqyruar sa më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	2006
1	TË ARDHURA	2 236 412
	Pagat	2 236 412
2	SHPENZIME	1 356 285
	Shpenzime jetese sipas ILDKPI	653 846
	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	325 150
	Shpenzime shkollimi	92 777
	Paguar kredia	284 512
3	Pasuri	3 711 090
4	Detyrime	1 237 030
	<i>Mbetur detyrim ndërtuesit</i>	<i>1 237 030</i>
5	Likuiditet fillim	2 244 090
6	Likuiditet fund	265 122
	DIFERENCA TË MUNDËSHME PËR KURSIM 1-2-(3-4-5+6)	385 035

Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se, subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës prej 15,000 USD deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2003 si dhe vlerat e deklaruara të kursyera në DPV 2004 dhe 2005.

- ✓ *Komisioni bazuar në analizën financiare ka konstatuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesën prej 20,000 eurosh për pronotimin e apartamentit, në vitin 2006.*

3. Pasuri e paluajtshme pyll dhe kullotë, Qarku Elbasan.

Burimi i krijimit: Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se burim krijimi është trashëgimia nga babai i tij dhe se zotëron ½ e 1/11 pjesë të kësaj pasurie.

Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DPV 2014, bashkëpronësinë për pasurinë e paluajtshme pyll dhe kullotë, të trashëguar për ½ e 1/11 pjesë në fshatin ***, Gramsh, sipas VKKP-së nr. 100, datë 06.07.2006, të Qarkut Elbasan.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se:

ZVRPP Gramsh²⁵, ka konfirmuar se, në emër të subjektit të rivlerësimit figurojnë të regjistruara në bashkëpronësi me 27 bashkëpronarë pasuritë, si më poshtë:

- pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji i pasurisë, pyll, me sipërfaqe 480,000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji i pasurisë, pyll, me sipërfaqe 150,000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji i pasurisë, kullotë, me sipërfaqe 80,000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji i pasurisë, pyll, me sipërfaqe 90,000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji i pasurisë, pyll, me sipërfaqe 80,000 m².

Nga verifikimi i dosjes së këtyre pasurive konstatohet se, Komisioni Vendor për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Qarku Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 06.07.2006, me nr. *** prot., datë 10.08.2006, ka vendosur:

(1) ti njohë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarëve të tjerë, sipërfaqen pyjore dhe tokën pyjore me sipërfaqe 910,000 m²; (2) ti kthejë sipërfaqen e pyllit dhe të tokës pyjore prej 880,000 m²; dhe (3) ti kompensojë në një nga format që njeh ligji sipërfaqen e tokës arë prej 30,000 m², të gjitha këto pasuri të ndodhura në fshatin ***, rrethi Gramsh.

Gjithashtu u konstatua se, është çelur trashëgimia ligjore në emër të trashëgimlënësit H. J. B, nëpërmjet vendimit nr. ***, të datës 02.05.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, nga ku provohet se ndër të tjerë edhe z. S. H. B (babai i subjektit të rivlerësimit) është “trashëgimtar ligjor”, i cili ka ndërruar jetë në vitin 1986. Referuar këtij vendimi, secili nga trashëgimtarët ligjor do të trashëgojë në pjesë të barabartë (1/11 pjesë secili), të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit.

Në pikën 3 të këtij vendimi parashikohet se, pjesën (1/11) të trashëgimtarit ligjor S. H. B, do ta trashëgojnë në pjesë të barabarta dy fëmijët e tij, me ½ pjesë secili, Artan S. Bajrami dhe A. S. B.

✓ *Komisioni vëren se, përputhet deklarimi i bërë nga ana e subjektit në deklaratën “Vetting”, me dokumentacionin e administruar në dosje dhe dokumentacionin e ardhur nga ZVRPP Gramsh.*

4. Gjendja e llogarisë në “Credins Bank”, më datë 24.01.2017, vlera prej 21,422 (njëzet e një mijë) lekësh.

“Credins Bank”²⁶, na informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari page pranë kësaj banke ku konfirmohet gjendja e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 24.01.2017.

²⁵ me shkresën nr. ***prot., datë 23.02.2018, nga ZVRPP Gramsh.

²⁶ “Credins Bank” me shkresën nr. ***prot., datë 30.03.2018.

- ✓ *Lidhur me këtë llogari, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

Pasuritë e deklaruara veçmas nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, (bashkëshortja dhe 2 fëmijët):

5. Gjendja e llogarisë së pagës të bashkëshortes, znj. M. B, në “Raiffeisen Bank” (me nr. *), në datën 24.01.2017, në vlerën prej 1,752 lekësh.**

“Raiffeisen Bank”²⁷, informon se llogaria e pagës në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nr. *** dhe gjendja, më datë 24.01.2017, është në vlerën prej 1,752 lekësh.

- ✓ *Lidhur me këtë llogari, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar në dosje dhe përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.*

6. Apartament banimi (2+1), me sipërfaqe 92 m² dhe një vend parkimi, në Tiranë, i ndodhur në rrugën “**”, i prenotuar nga e bija e subjektit të rivlerësimit, R. B në vitin 2014, me vlerë 9,800,000 lekë. Deklaruar si e shlyer shuma në total prej 7.1 milion lekë. Detyrim i mbetur është në shumën prej 2.7 milion lekë.**

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, si **burim krijimi** për këtë pasurisë:

- i. kursimet familjare ndër vite, shuma prej 20,000 eurosh;
- ii. depozita bankare plus interesa, shuma prej 8,909 eurosh, tërhequr, më datë 08.10.2013, nga “Credins Bank”;
- iii. kursimet e saja personale, në shumën prej 150,000 lekësh;
- iv. marrje huaje, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.02.2014, në shumën prej 20,000 eurosh.

Mënyra e fitimit të pasurisë: nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes për prenotim apartamenti në ndërtim me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.01.2014, lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe znj. R. B, në cilësinë e palës blerëse.

Referuar DPV 2014 të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar:

Apartament banimi (2+1), me sipërfaqe 92 m² + një vend parkimi, prenotuar nga vajza e subjektit, R. B, me kontratën e sipërmarrjes, datë 20.01.2014, lidhur me shoqërinë “**”.**

- i. Vlera e deklaruar: 9,800,000 lekë;
- ii. Vendndodhja: Rruga “****”, pranë ***, Tiranë;
- iii. Pagesa e kryer në vitin 2014: 7,100,000 lekë;
- iv. Burimi i krijimit: (1) 20,000 euro kursimet ndër vite;
(2) 1,250,000 lekë depozita në emër të së bijës;

²⁷ “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 14.02.2018.

(3) 150,000 lekë kursime të së bijës

(4) 20,000 euro hua sipas kontratës noteriale të datës 18.02.2014.

Nga verifikimi i dokumentit, kontratë sipërmarrje (për prenotim apartamenti) me nr. *** rep., nr. *** kol., datës 20.01.2014, konstatohet se R. B ka prenotuar te shoqëria “***” sh.p.k., një apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi përafërsisht 110 m² dhe sipërfaqe të hipotekueshme 92.86 m², sipërfaqe që do të shfrytëzojë për nevojat e veta 17.14 m², si dhe të një vend parkimi, pozicioni i të cilit do të përcaktohet në një fazë të dytë.

Në nenin 2 të kësaj kontrate është parashikuar se, vlera e përgjithshme (çmimi) e apartamentit së bashku me vendparkimin është 9,800,000 lekë dhe se mënyra e pagesës së kësaj shume do të jetë:

- i. me nënshkrimin e kësaj kontrate blerësi do të paguajë shumën 2,800,000 lekë dhe do ti jepet një mandatarkëtim nga shoqëria “***” sh.p.k.;
- ii. diferenca në shumën prej 7,000,000 lekësh, do të paguhet për një periudhë tre vjeçare, duke filluar që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Bashkëlidhur kësaj kontrate, janë dorëzuar edhe tre mandatarkëtime, sipas të cilave, R. B, ka kryer pagesën në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., pagesat për prenotimin e këtij apartamenti, janë si më poshtë:

- i. më datë 08.01.2014, shumën prej 2,800,000 lekësh;
- ii. më datë 23.02.2014, shumën prej 2,800,000 lekësh;
- iii. më datë 03.12.2014, shumën prej 1,500,000 lekësh.

➤ **Komisioni ka kryer verifikime lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie:**

a) Shuma prej 20,000 euro, deklaruar si kursime familjare ndër vite.

Referuar DPV 2006, subjekti ka deklaruar kursime *cash*, në shumën prej 200,000 lekësh.

Referuar DPV 2007, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 300,000 lekësh, nga të ardhurat nga pagat 2007.

Referuar DPV 2008, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 400,000 lekësh, nga të ardhurat nga pagat 2008.

Referuar DPV 2009, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 250,000 lekësh, nga të ardhurat nga pagat 2009.

Referuar DPV 2010, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 350,000 lekësh, përgjatë vitit 2010.

Referuar DPV 2011, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 400,000 lekësh, përgjatë vitit 2011.

Referuar DPV 2012, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 350,000 lekësh, përgjatë vitit 2012.

Referuar DPV 2013, subjekti ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre): *cash*, në shumën prej 300,000 lekësh, përgjatë vitit 2013.

Komisioni nga përllogaritja e kryer ka konstatuar se, kursimet e subjektit të rivlerësimit për vitet 2006 - 2013 sipas vetëdeklarimit arrijnë në vlerën prej 2,550,000 lekësh.

b) *Depozita bankare plus interesa, në shumën prej 8,909 eurosh.*

Në DPV 2009, në rubrikën “*detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizik*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (1) shumën prej 500,000 lekësh të ardhura nga paga e së bijës, të depozituara në “Alpha Bank”; dhe (2) shumën prej 1,800 eurosh, kursime të së bijës të depozituara në një bankë në Greqi.

Referuar DPV 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime të së bijës ndër vite në valutë në shumën prej 1,800 eurosh, të tërhequra nga depozita e bankës në Selanik.

Referuar DPV 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet (shtesat e tyre) të së bijës: vlerën *cash* prej 100,00 lekësh, të depozituara në “Alpha Bank”.

Referuar DPV 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, transferimi i depozitave në “Credins Bank”, më datë 05.10.2012, në shumën prej 1,000,000 lekësh, ku përfshihen edhe kursimet e së bijës për vitin 2012 nga të ardhurat nga paga si specialiste në Ministrinë e Ekonomisë.

Referuar DPV 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, (1) kursime të së bijës për vitin 2013, në vlerën prej 150,000 lekësh; dhe (2) interesa kreditore, depozita në emër të së bijës, vlerën prej 66,995 lekësh.

“Alpha Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.05.2018, na konfirmon se shtetasja R. B ka llogari bankare pranë kësaj banke. Nga verifikimi i llogarive në lekë dhe në valutë të R. B në “Alpha Bank”, ndër të tjera konstatohet se:

Llogaria në “Alpha Bank”, në lekë

- i. më datë 31.12.2009, ka pasur gjendje depozitën në vlerën prej 500,000 lekësh;
- ii. më datë 31.12.2010, ka pasur gjendje depozitën në vlerën prej 500,000 lekësh;
- iii. më datë 18.05.2011, ka derdhur *cash* shumën prej 86,000 lekësh, për depozitë me afat;
- iv. më datë 19.05.2011, ka mbyllur para afatit depozitën në shumën prej 512,273 lekësh dhe ka tërhequr *cash* nga kjo llogari shumën prej 500,000 lekësh;
- v. më datë 20.05.2011, ka çelur depozitën 12 mujore në shumën prej 100,000 lekësh, e cila përbëhet nga shuma prej 86,000 lekësh e depozituar, më datë 18.05.2011, dhe interesat e përfituara nga depozita e mëparshme me principal në shumën 500,000 lekë;

- vi. më datë 02.07.2012, ka mbyllur para afatit depozitën në shumën prej 105,866 lekësh dhe ka tërhequr shumën prej 104,400 lekësh.

Llogaria në “Alpha Bank”, valutë (euro).

- i. më datë 30.12.2010, ka çelur depozitën 12 mujore në valutë, në shumën 2,000 euro;
ii. më datë 02.07.2012, është prishur para depozita në valutë në këtë bankë dhe është tërhequr shuma prej 2,050 eurosh *cash* nga kjo llogari.

“Credins Bank”²⁸, ndër të tjera na informon se shtetasja R. A. B është kliente e kësaj banke, duke na dërguar printimin e këtyre llogarive që nga momenti i çeljes deri më datë 20.03.2018.

Nga verifikimi i llogarive në lekë (me nr. ***) dhe në valutë (në euro me nr. ***) të R. B pranë “Credins Bank”, ndër të tjera konstatohet se:

- i. më datë 05.10.2012, R. B ka derdhur *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh;
ii. më datë 05.10.2013, ka përfituar interesat kreditore në shumën prej 66,955.86 lekësh dhe i është mbajtur tatimi mbi interesin në shumën prej 6,695.59 lekësh;
iii. më datë 07.10.2013, ka derdhur *cash* shumën prej 140,000 lekësh;
iv. më datë 05.10.2014, ka përfituar interesat kreditore në shumën prej 50,378.71 lekësh dhe i është mbajtur tatimi mbi interesin në shumën prej 5,037.88 lekësh;
v. më datë 05.10.2014, shuma 1,245,601.10 lekë, që ndodhet në llogarinë në lekë të R. B pranë “Credins Bank”, nëpërmjet një urdhërxhirimi të brendshëm transferohet në llogarinë në valutë (euro) me nr. *** lekë, duke konvertuar në shumën prej 8,909.88 eurosh dhe po më këtë datë është tërhequr *cash*.

c) Kursimet e Rediana Bajramit, në shumën prej 150,000 lekësh.

Referuar DPV 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime të së bijës (shtetas e tyre), për vitin 2013, në vlerën prej 150,000 lekësh.

✓ **Komisioni nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (vajza e subjektit) ka burime të ligjshme për të krijuar këto kursime.**

d) Huaja, e marrë sipas kontratës noteriale në shumën prej 20,000 eurosh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së konstatohet se, më datë 18.02.2014, është lidhur kontrata e huas me nr. *** rep., nr. *** kol., ndërmjet, z. S. L, në cilësinë e huadhënësit dhe znj. R. B dhe z. Artan Bajrami, në cilësinë e palës huamarrëse. Referuar kësaj kontrate noteriale, z. S. L, deklaroi se i ka dhënë huamarrësve R. B dhe Artan Bajrami, më datë 12.02.2014, një hua në shumën prej 20,000 eurosh. Shuma e mësipërme i është dhënë hua, për një periudhë kohore 3 (tre) vjet duke filluar nga data e legalizimit të kësaj kontrate. Këtë detyrim, më datë 11.02.2016, subjekti e ka shlyer në shumën 1 milion lekë me burim të deklaruar, kursimet nga pagat e familjes në vitin 2015 dhe më datë

²⁸ “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 30.03.2018.

12.12.2016, ka shlyer në shumën 600,000 lekë, kursimet nga pagat e familjes për vitin 2016. Këto pagesa në favor të shtetasit Skënder Lena janë kryer nëpërmjet bankës.

Bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se shtetasi S. L bën pjesë në kategorinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Komisioni ka kryer verifikime, lidhur me burimin e ligjshëm të huas nga z. S. L. QKB-ja²⁹, ka konfirmuar pranë ILDKPKI-së se:

- i. Nga verifikimi i të dhënave të Regjistrit të Shoqërive Tregtare, transferuar në QKB nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, figuron i regjistruar me vendimin, nr. ***, datë 14.02.2005, të kësaj gjykate, subjekti “***” sh.p.k., me ortak të vetëm shtetasin S. L, i datëlindjes 15.03.1945 (jo i vitit 1941).
- ✓ DPT-ja dhe DRT-ja Tiranë kanë konfirmuar pranë ILDKPKI-së, se shtetasi S. K. L, i datëlindjes 15.03.1941 (gjeneralitet e plota të huadhënësit), është aksioner 100 % në shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***, me aktivitet në fushën e ndërtimit dhe se kjo shoqëri ka realizuar qarkullimin, fitimin/humbjen dhe ka shpërndarë dividendin si më poshtë:

Periudha	Qarkullimi (lekë)	Fitimi/Humbja (lekë)	Dividenti (lekë)
2010	18,657,383	Fitimi: 12,121,737	40,000
2011	6,536,504	Fitimi: 6,079,269	250,000
2012	36,349,229	Fitimi: 25,889,833	0
2013	10,959,043	Fitimi: 7,779,819	150,000
2014	9,962,673	Fitimi: 8,441,449	0
2015	135,144,155	Fitimi 28,934,268	0
2016	139,920,513	Fitimi 33,318,287	0

Nisur nga të dhënat e përfituara nga verifikimi i faqes së QKB-së së këtij subjekti, konkretisht të vendimeve të asamblesë për shpërndarjen e dividendit, konstatojmë se subjekti “***” sh.p.k., me NIPT ***, për vitet 2010, 2011 dhe 2013, ka shpërndarë në formë dividendi në total shumën prej 4,400,000 lekësh, ka paguar tatimin mbi dividendit në total shumën 440,000 lekë dhe ka përfituar të ardhura neto nga dividendi shumën prej 3,960,000 lekësh.

Komisioni ka kërkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, të dhëna lidhur me të ardhurat e realizuara, fitimet e deklaruara, fitimin neto mbas tatimit, dividendin e shpërndarë dhe pagesën e tatimit mbi dividendit, për shoqëritë “***” sh.p.k., me NIPT *** dhe “***” sh.p.k., me NIPT ***.

- ✓ Komisioni nga hetimi i kryer ka konstatuar se, shtetasi S. L, ka pasur mundësi financiare për t’i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën prej 20,000 eurosh;
- ✓ Komisioni nga verifikimi i dokumentacionit ka konstatuar se, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar në dosje;
- ✓ Nga analiza financiare e kryer për vitet 2007 - 2016 konstatojmë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë burime të ligjshme për pagesat e kryera në favor të

²⁹ QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.08.2017.

shoqërisë “***” dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj z. S. L në shumën prej 1.6 milion lekësh në vitin 2016.

7. Gjendja e llogarisë së pagës të vajzës së subjektit të rivlerësimit, R. B, në “Tirana Bank” (me nr. ***), më datë 24.01.2017, në vlerën prej 166,529 lekësh.

“Tirana Bank”³⁰, informon se, R. Artan Bajrami, ka llogari pranë kësaj banke me nr. ***, të çelur në vitin 2011. Nga verifikimi i kësaj llogarie konfirmohet se kjo është një llogari page dhe gjendja e saj, më datë 24.01.2017, është në vlerën 166,529 lekë.

✓ *Nga verifikimi i kësaj llogarie Komisioni konstaton se, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar në dosje dhe ka burime të ligjshme për krijimin e kësaj shume.*

8. Autoveturë, tip “Audi A3”, me vlerë 5,000 euro, e blerë në vitin 2014, në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, z. A. B. Si burim të krijimit ka deklaruar kursimet e tij ndër vite nga paga si dhe kursimet e familjes. Mënyra e fitimit të pasurisë nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2014.

DPSHTRR³¹, informon se A. S. Bajrami ka në pronësi mjetin me targë ***, të regjistruar për herë të parë, më datë 15.10.2014, pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë.

DRSHTRR Tiranë³², ka dërguar kopje mbi dosjen e plotë të mjetit me targë ***, ku nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur saj konfirmohet se ky automjet ka kaluar në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.0.2014.

✓ Komisioni nga verifikimi i dokumentacionit ka konstatuar se, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar në dosje dhe nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

10. Gjendja e llogarisë së pagës të djalit të subjektit të rivlerësimit, z. A. B, në “Credins Bank” (me nr. ***), më datë 24.01.2017, në vlerën prej 535 lekësh.

“Credins Bank”³³, ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie, më datë 24.01.2017, në emër të A. A. Bajrami(djali i subjektit).

*Hetimi i kryer lidhur me automjetin, tip “BMW X5”, me targë ***.*

Referuar “pyetësorit tip” subjekti i rivlerësimit u pyet nëse për shtatë vitet e fundit ka përdorur pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër, ndër të tjera subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se

³⁰ “Tirana Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.02.2018.

³¹ DPSHTRR, me shkresën nr. ***1 prot., datë 20.02.2018.

³² DRSHTTR Tiranë, me shkresën nr. ***prot., datë 21.11.2018.

³³ “Credins Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 30.03.2018.

ka përdorur automjetin, tip “BMW X5” me targa ***, në pronësi të shoqërisë së sigurimeve “****” sh.a, me aksioner kryesor z. P. A dhe se ky automjet është përdorur vetëm për udhëtime jashtë shtetit.

Në vijim të veprimeve hetimore, nga Komisioni u kryen verifikime në faqen e Web-it të **Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare**, me qëllim evidentimin e policave të sigurimit të këtij mjeti, ku rezultoi se, në disa polica (polica kufitare, karton jeshil dhe TPL), subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij figuronin në rubrikën e përdoruesit, ndërsa në disa polica të tjera emri i subjektit të rivlerësimit është shënuar në rubrikën e “pronarit”.

DPSHTRR³⁴, ka dërguar pranë Komisionit kopje mbi dosjen e plotë të këtij automjeti, ku nga verifikimi u konstatua se:

- i. Ky mjet ka qenë në pronësi të shtetasit D. S³⁵ dhe fillimisht është pajisur me targat ***;
- ii. Më datë 01.11.2012, shtetasi D. S, ia shet këtë mjet shoqërisë “****” sh.a., për vlerën prej 50,000 euro (sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. ***kol.);
- iii. Më datë 13.11.2012, shoqëria “****” sh.a., ia shet këtë mjet shoqërisë “Tirana Leasing” sh.a., për vlerën prej 50,000 euro (sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol.);
- iv. Më datë 20.01.2015, shoqëria “Tirana Leasing” sh.a., ia shet këtë mjet shoqërisë “ANSIG” sh.a., për çmimin 1 euro (sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol.).

Komisioni, me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 18.12.2018, i është drejtuar dy shoqërive “ANSIG” sh.a., dhe “Tirana Leasing” sh.a., duke i kërkuar të na venë në dispozicion dosjen e plotë ku të përfshihen kontratat e shitblerjes, kontrata e qirasë financiare (nëse ka) dhe dokumentacion bankar/jo bankar lidhur me pagesat e kryera.

“ANSIG” sh.a., dhe “Tirana Leasing” sh.a.,³⁶ ka konfirmuar se mes dy shoqërive është lidhur një kontratë qiraje financiare (leasing) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2012, për automjetin, tip “BMW X5”, me targë ***. Referuar dokumentacionit të dërguar shoqëria “ANSIG” sh.a., në muajin nëntor të vitit 2014 ka shlyer tërësisht detyrimet ndaj shoqërisë “Tirana Leasing” sh.a., që kanë të bëjnë me blerjen e këtij automjeti.

Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, i jemi drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, duke i kërkuar kopje të njehsuara me origjinalin e policave të sigurimit si edhe çdo dokumentacion shoqërues për, TPL-të, kartonët jeshil dhe policat kufitare të lëshuara për automjetin, tip “BMW X5”, me targë ***.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare³⁷, na ka dërguar policat e sigurimit për këtë mjet, ku të dhënat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji i sigurimit	Nr. Serial i Policës	Policmbajtësi	I siguruari	Datë fillimi	Datë mbarimi	Shoqëria e sigurimit
----	-------------------	----------------------	---------------	-------------	--------------	--------------	----------------------

³⁴ DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë 05.11.2018.

³⁵ Subjekti ka deklaruar lidhje shoqërore me këtë shtetas dhe se ka kryer disa udhëtime jashtë shtetit me të.

³⁶ Me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., të protokolluara me tonën nr. *** dhe nr. *** prot., datë 04.01.2018.

³⁷ AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018.

1	TPL-01	45089 25700 25699	A.B/Artan Bajrami	Tirana Leasing	23.04.2013	22.04.2014	ANSIG
2	TPL-01	11808886	A. B/Artan Bajrami	Tirana Leasing	22.04.2014	21.04.2015	ANSIG
3	TPL-01	1614981	Bajrami	Tirana Leasing	21.04.2015	21.04.2015	ANSIG
4	Karton Jeshil- 02	180066773	Sipas Autorizimit Artan Bajrami/ A. B	ANSIG	12.06.2018	26.06.2018	ANSIG
5	Karton Jeshil- 02	180119118	Sipas Autorizimit/ A. B	ANSIG	12.08.2018	26.08.2018	ANSIG
6	Karton Jeshil- 02	129868	A. B	Tirana Leasing/ Artan Bajrami	26.02.2015	25.05.2015	ALBSIG
7	Karton Jeshil- 02	167870	A. B	Tirana Leasing/ Artan Bajrami	28.07.2015	27.08.2015	ALBSIG
8	Karton Jeshil- 02	101361		Tirana Leasing/ Artan Bajrami	06.11.2014	20.11.2014	INTERSI G
9	Karton Jeshil- 02	1382751		Artan Bajrami	24.04.2013	08.05.2013	INTERSI G
10	Karton Jeshil- 02	66687	Artan Bajrami/ A. B	Tirana Leasing	31.07.2014	30.08.2014	SIVIG
11	Karton Jeshil- 02	189778	Artan Bajrami/ A. B	Tirana Leasing	11.09.2015	10.10.2015	SIVIG
12	Karton Jeshil- 02	307837	Artan Bajrami/ A. B	Ansigt Sh.a	02.07.2016	01.10.2016	SIVIG
13	Karton Jeshil- 02	1321336	A. B	Artan Bajrami	09.01.2013	08.02.2013	SIVIG
14	Karton Jeshil- 02	297024	A. B	Ansigt sh.a./ Artan Bajrami	22.04.2016	06.05.2016	SIVIG

Komisioni referuar të dhënave të mësipërme dhe materialeve të administruara në dosje konstaton se:

- Ky mjet fillimisht ka qenë në pronësi të mikut të subjektit të rivlerësimit, e në vijim ka kaluar në pronësi të shoqërisë “ANSIG” sh.a, e cila e ka shitur, për ta riblerë përsëri nëpërmjet marrëveshjes së qirasë financiare me shoqërinë “Tirana Leasing” sh.a.
- Në policat e sigurimit (TPL dhe karton jeshil), vërehet se në vazhdimësi në rubrikat “policmbajtësi” dhe “i siguruari”, janë shënuar emrat e subjektit të rivlerësimit dhe djalit të tij.
- Megjithëse ky mjet, (1) ka qenë në pronësi/posedim të shoqërisë “ANSIG” sh.a., (2) djali i subjektit të rivlerësimit ka qenë punonjës i shoqërisë “ANSIG” sh.a., për periudhën janar 2013 - prill 2014³⁸ si edhe (3) faktit që subjekti i rivlerësimit ka lidhje familjare me

³⁸ Referuar vetëdeklarimit të subjektit në deklaratën “Vetting” dhe vërtetimit lëshuar nga shoqëria “ANSIG” sh.a., të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së.

aksionerin kryesor të shoqërisë “ANSIG” sh.a., vërejmë se një pjesë e konsiderueshme e policave të sigurimit janë bërë në kompani të tjera sigurimi, përfshirë dhe periudhën që djali i subjektit ka qenë i punësuar në shoqërinë “ANSIG” sh.a.

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë automjet e ka përdorur vetëm për udhëtime jashtë shtetit, ndërkohë që konstatohet se emri i tij dhe i djalit të tij evidentohet në policat e sigurimit të tipit TPL që janë siguracione vjetore për qarkullimin e mjetit brenda Republikës së Shqipërisë.

➔ **Nisur nga indicet e mësipërme, ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit mund të jetë pronar “de facto” i automjetit, tip “BMW X5”, me targë ***.**

Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti me shpjegimet e tij, më datë 08.02.2019, ka pranuar përdorimin e këtij mjeti si brenda dhe jashtë vendit duke argumentuar ndër të tjera se:

“Automjeti në fjalë në pronësi të shoqërisë “ANSIG” sh.a., (me aksioner kryesor, z. P. A) është përdorur brenda dhe jashtë vendit, nga unë dhe djali A.,i kundrejt autorizimeve të lëshuara nga kjo shoqëri.

Referuar ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, neni 2/b, për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, parashikon që sigurimi i detyrueshëm për mjetet motorrike konsiston në sigurimin e përgjegjësisë së pronarit dhe përdoruesit të mjetit gjithmonë me autorizim të pronarit të mjetit. Djali im A. për një periudhë ka qenë i punësuar në këtë shoqëri sigurimesh.”

*Fakti i pasqyruar se mjeti deri në vitin në 2016 është pajisur me policë sigurimi të detyrueshëm jashtë territorit shqiptar (karton jeshil) pranë kompanive të ndryshme shqiptare, ka ndodhur se kompania “ANSIG” nuk kishte autorizim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për shitjen e Kartonit Jeshil. Pas këtij viti mjeti është siguruar me policë Karton Jeshil pranë shoqërisë “ANSIG” sh.a., (shkresa nr. ***, datë 19.09.2016, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për pajisjen e shoqërisë “ANSIG” sh.a., me karton jeshil).*

*Referuar shkresës nr. ***, datë 04.02.2019, të lëshuar nga kjo kompani rezulton se shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes, sigurimeve dhe taksave janë paguar nga shoqëria “ANSIG” sh.a.*

Për të hequr çdo dyshim që ky mjet nuk ka qenë i imi, dua t’ju bëj me dije se për shkak të funksionit si Drejtues i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda nga viti 2004 e në vazhdim, pa ndërprerje kam pasur në dispozicion automjet dhe shofer. Sipas ligjit nr. 10160, viti 2009 deri në vitin 2013 kam qenë përfutues i këtij shërbimi në dispozicion të përhershëm, kategoria e parë, të përcaktuar në lidhjen 1. Gjithashtu për sa është pasqyruar në deklaratat e pasurisë, djali im A. nga viti 2016 është pronari një automjeti veturë për përdorim vetjak dhe të nevojave të familjes”.

Bashkangjitur shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit, ka vënë në dispozicion autorizimet për përdorimin e mjetit si dhe fatura të shërbimeve për këtë automjet si dhe kopje të shkresës nr. ***, datë 19.09.2016, të AMF-së për pajisjen e shoqërisë “ANSIG” sh.a., me karton jeshil, të

cilat janë administruar në dosjen hetimore.

- ✓ **Trupi gjykues nuk arriti të provonte se subjekti i rivlerësimit zotëronte automjetin, tip “BMW X5”, me targë ***.**

Për sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI -ja për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim i thelluar dhe i gjithanshëm administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, janë marrë në konsideratë edhe shpjegimet, dokumentet e paraqitura nga subjekti në ushtrim të së drejtës së barrës së provës sipas parashtrimeve të datës 08.07.2018, si dhe parashtrimet e tij në seancë dëgjimore, u konstatua se në deklaratën “Vetting”:

- ⊗ *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë, sipas parashikimeve të nenit 33/ç, të ligjit nr. 84/2016.*
- ⊗ *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar me vërtetësi burimin e ligjshëm të pasurisë për apartamentin në Tiranë, sipas parashikimeve në paragrafet 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
- ⊗ *Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të pasakta, jo në përputhje me ligjin, sipas parashikimeve të nenit 33/ të ligjit nr. 84/2016.*

ii. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin, me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 11.04.2018), për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami”.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ **Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.**

iii. VLERËSIMI PROFESIONAL

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, në periudhën 01.09.1983 - 15.10.1986, ka ushtruar funksionin si hetues në Hetuesinë e Rrethit Elbasan; në periudhën 16.10.1986 - 15.08.1990, ka ushtruar funksionin si hetues në Hetuesinë e Përgjithshme; në periudhën 16.08.1990 - 15.07.1991, ka ushtruar funksionin si kryetar hetuesie në Hetuesinë e Rrethit Pukë; në periudhën 16.09.1991 - 31.08.1996, ka ushtruar funksionet si hetues, kryetar hetuesie, zv/prokuror dhe prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gramsh; në periudhën shtator 1996 - dhjetor 2003 ka ushtruar funksionin si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme; dhe për periudhën nga muaji janar i vitit 2004 - aktualisht, ushtron detyrën prokurorit/Drejtues pranë Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Raporti i mbajtur nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit: Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Detyrat e kryera tre vitet e fundit: Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, gjatë tre viteve të fundit ka ushtruar funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit: Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tre dokumente ligjore, nga të cilat dy të natyrës: “*Konkluzione për gjykimin e çështjeve në themel*” dhe një të natyrës: “*Konkluzione për gjykimin e çështjes për masë sigurimi*”.

Pesë dosje të përzgjedhura me short: Më datën 18.01.2018, në ambientet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në prani anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe në prani të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami, u përzgjedhën me short pesë çështje. Përgjatë procedurës së shortit nuk pati vërejtje apo kontestime nga të pranishmit. Nga shorti i hedhur, rezulton se u përzgjedhën në mënyrë rastësore pesë dosje. Dosjet u vunë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe u procedua menjëherë me vëzhgimin e tyre dhe analizën e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi. Në raport është bërë në mënyrë të detajuar përkrahimi dhe analiza e këtyre dosjeve.

Të dhëna nga burime arkivore: Subjekti rivlerësimit nuk rezulton të ketë të dhëna, për masa disiplinore dhe ankesa, në burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore.

Analiza e gjetjeve:

Nga analizimi i tre dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, Grupi i Punës në

Prokurorinë e Përgjithshme ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) *Aftësitë profesionale;*
- b) *Aftësitë organizative;*
- c) *Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe*
- ç) *Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

Aftësitë profesionale: Subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara pas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në shtatë raste (përfshirë edhe rastet kur ka lapsuse) dhe nuk e ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në një rast.

Në shumicën e rasteve analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Konstatohet se ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Artan Bajrami, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Në çështje problematike të interpretimit në normës në raport me faktin penal të ndodhur, subjekti i kushton rëndësi analizës së normës ligjore procedurale. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative: Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit nga 2004 e në vijim ka kryer detyrën e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal. Referuar të dhënave statistikore për punën e kryer, rezulton se prokurori ka përballuar me efikasitet një ngarkesë normale pune.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon Prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurori të detyrohej të arsyetonte aktet e saj. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për shkak të mospregatitjes së tij për çështjen në gjykim.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, është eficient dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, disponimin e Gjykatave.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale: Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, tetor 2013 - tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Bajrami, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional: Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në tre dokumentet e dorëzuara prej subjektit, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë dokument që të tregojë angazhimin e tij akademik apo pjesëmarrjen në trajnimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

✓ *Sipas të dhënave të regjistrit të denoncimeve, pranë Komisionit, nuk është paraqitur asnjë denoncim për këtë subjekt.*

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efecient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk gjeta asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurorit, z. Artan Bajrami, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, kështu që për subjektin e rivlerësimit propozoj: “I aftë”.

V. KONKLuzioni PëRFUNDIMtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, i cili deklaroi në seancë se është dakord me të gjitha gjetjet e bëra nga Komisioni, të cilat kanë qenë korrekte dhe ligjore dhe kërkoi konfirmimin në detyrë, mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konkludon përfundimisht se:

Për vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimeve pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Bajrami:

- a. ka deklarim të pasaktë dhe mospërputhje deklarimesh;
- b. ka deklarim të rremë;
- c. ka bërë deklarim të pamjaftueshëm.

Për kontrollin e figurës, subjekti ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin profesional, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efecient dhe efektiv në masë të pranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe pika 5, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami.

2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 14.02.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese

Suela Zhegu
Relatore

Brunilda Bekteshi
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka